



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

Drejtoria e Ligjshmërisë

Tiranë më

Nr.

**RELACION**  
**PËR**  
**PROJEKTVENDIMIN**  
**PËR**  
**“PËR SHPALLJEN E REZULTATIT PËRFUNDIMTAR TË ZGJEDHJEVE TË**  
**PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË HIMARË, TË DATËS 4 GUSHT 2024”**

**I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME**  
**LEGJISLACIONIN NË FUQI**

Referuar nenit 20, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni Rregullator shqyrton dhe miraton projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së, për rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në shkallë vendi, në përputhje me këtë ligj.

Referuar nenit 167, të Kodit Zgjedhor, rezultati përfundimtar i zgjedhjeve shpallet nga KQZ-ja jo më vonë se 5 ditë nga data e shpalljes së rezultatit për shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore, dhe pasi të kenë përfunduar procedurat e ankimit, sipas këtij Kodi.

**II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT**

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit nr. 244, datë 5.7.2024, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë Himarë”, u zhvilluan zgjedhjet e pjesshme të datës 4 gusht 2024.

Bazuar në nenin 166, pika 1, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, Kryetar Bashkie zgjidhet kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që kanë votuar në njësinë vendore përkatëse.

Në mbështetje të nenit 33, shkronja “g”, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 88, me vendimin nr. 85, datë 5.8.2024, ka shpallur fitues z. Vangjel Llambi Tavo, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

Kundër Vendimit të KZAZ nr. 88, në datën 9.8.2024 është depozituar në KAS kërkesa ankimore me nr. 11 nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, me objekt:

- Kundërshtimin e vendimit nr. 85, datë 5.8.2024 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Himarë në zgjedhjet e pjesshme të datës*

- 4.8.2024”, të KZAZ nr. 88;
2. Pavlefshmerinë e zgjedhjeve të zhvilluara në të gjitha QV (gjithsej 36 QV-të) të zonës zgjedhore, Bashkia Himarë;
  3. Rregullimin e pasojave duke shpallur pavlefshmerinë e zgjedhjeve për bashkinë Himarë.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, pasi shqyrtoi çështjen, me vendimin nr. 19, datë 26.8.2024 vendosi rrëzimin e kërkesës ankimore dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 85, datë 5.8.2024 të KZAZ nr. 88.

Kundër Vendimit nr. 19, datë 26.8.2024 të KAS, janë depozituar 2 (dy) kërkesë padi pranë Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor në datën 3.9.2024, nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë” dhe “Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut”.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor me vendimin nr. 5, datë 9.9.2024 vendosi unanimitisht, rrëzimin e padisë së palës paditëse Koalicioni “Bashkë Fitojmë” dhe “Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 177, datë 12.9.2024 “Për dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë, Qarku Vlorë z. Vangjel Llambi Tavo, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 Gusht 2024”, i ka dhënë mandatin e Kryetarit të Bashkisë Himarë, z. Vangjel Llambi Tavo.

Komisioni Rregullator, pas dhënies së mandatit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 20, pika 2, shkronja “d” dhe nenit 167 të Kodit Zgjedhor, shpall me vendim rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve.

Për sa më sipër në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërmjet administratës, i propozon Komisionit Rregullator për shqyrtim dhe miratim projektvendimin “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024”.

**Sekretar i Përgjithshëm**

**(në mungesë dhe me urdhër)**

**Majlinda ÇELMETA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONI RREGULLATOR

Data: \_\_.\_\_.2024

Nr:

Ora: \_\_:\_\_

VENDIM

PËR

**PËR SHPALLJEN E REZULTATIT PËRFUNDIMTAR TË ZGJEDHJEVE TË  
PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË HIMARË, TË DATËS 4 GUSHT 2024**

Në mbështetje të nenit 20, pikat 2, shkronja “d”, e 3, dhe nenit 167, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator,

V E N D O S I:

- Të shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024, si më poshtë:
  - z. Vangjel Llambi Tavo, kandidat fitues për Kryetar të Bashkisë Himarë, Qarku Vlorë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

**Ilirjana NANO**

**Kryetar**

**Arens ÇELA**

**Anëtar**

**Dritan ÇAKA**

**Anëtar**

**Helga VUKAJ**

**Anëtar**

**Muharrem ÇAKAJ**

**Anëtar**

Kopje: 3

Afati i ruajtjes: 5 vjet

Kompjuterizoi:

M. Koja \_\_\_\_\_

A. Lamçe \_\_\_\_\_

M. Çelmeta \_\_\_\_\_

Data: \_\_.\_\_.2024 Nr:  
Ora:



“Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024”.